



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1596/1 prot.

Tiranë, më 10.12.2021

V E N D I M

Nr. 235, datë 10.12.2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 217 Regj., datë 18.11.2021, të shtetasit M. K, kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Fier, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “moshës”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e sjellë pranë KMD-së, rezulton se subjekti ankues, M. K, aktualisht është përfitues i pensionit të pleqërisë.

Sipas marrëveshjes së lidhur mes ankuesit dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier, me nr. 1610, datë 19.07.2011, rezulton se ai ka bërë pagesa kontributesh, për vjetërsi pensioni për periudhën nga 01.01.1994, deri në datën 31.12.2008, në vlerën 68220 lekë.

Ankuesi është shprehur se: “Për të përfituar pension të plotë, jo vetëm atë të kooperativës, me vullnetin tim të lirë dhe përgjegjësi të plotë kam “blerë” 15 vjet e gjysëm, në vlerën 68220 lekë. Pra, pasi kam bërë një marrëveshje për sigurim vullnetar, kam kryer pagesën, mora

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

mandatin e pagesës, dokumentacionin e punës, ushtrisë dhe i dorëzova tek DRSSH Fier, ku u firmosën nga të dyja palët.

Por kur erdhi dita që dola në pension, masa e caktuar e pensionit ishte minimale dhe qesharake, ku ishin caktuar vetëm 19 vite pune kooperative dhe nuk figuronte gjëkund kontributi i derdhur prej meje për të përfutur pension të plotë, se përndryshe ato lekë mund t'i investoja diku tjetër dhe nuk do isha duke u lutur ende për të fituar të drejtën time. Kanë “vjedhur” gjakun dhe djersën time, duke qenë i vetëm në këtë sistem të korruptuar”.

Ankuesi është shprehur se ka vajtur disa herë me bashkëshorten tek DRSSH Fier për të sqaruar këtë problematikë të tij, por është përcjellë nga punonjësit e këtij institucioni me përgjigjen verbale se është paraqitur vonë dhe i kanë kaluar afatet e ankimit.

Në përfundim të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit nga DRSSH Fier, për shkak të moshës.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar², në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues pranë KMD-së, konstatohet se:

² Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

- Me Vendimin nr. 2288, datë 21.11.2011, DRSSH Fier i ka caktuar ankuesit pension pleqërie të pjesshëm kooperative, me periudhë sigurimi 19 vjet me bazë mesatare mujore e vlerësuar mbi të cilën llogaritet pensioni minimal me të drejtë pagese nga data 13.05.2011 e përgjithmonë, në masën 4628 lekë.
- Ankuesi nuk ka qenë dakord me masën e pensionit të caktuar nga DRSSH Fier dhe e ka kundërshtuar atë pranë Komisionit Rajonal të Ankimimit, pranë DRSSH Fier.
- Komisioni Rajonal i Ankimimit, pranë DRSSH Fier, pasi ka shqyrtuar ankimimin e z. M. K, nëpërmjet Vendimit nr. 15, datë 20.01.2012, ka vendosur të rrëzojë kërkesën e tij dhe të lërë në fuqi Vendimin nr. 2288, datë 21.11.2011 të DRSSH Fier.
- Ankuesi ka kundërshtuar Vendimin e Komisionit Rajonal të Ankimimit pranë DRSSH (KRA) Fier, në Komisionin Qendror të Ankimit pranë Inститutit të Sigurimeve Shoqërore (ISHSH), i cili, nëpërmjet Vendimit nr. 204, datë 01.04.2012, pasi ka shqyrtuar pretendimet e ankuesit, ka vendosur të rrëzojë kërkesën e M. K dhe të lërë në fuqi Vendimin nr. 15, datë 20.01.2011 të KRA Fier.
- Subjekti ankues nuk ka depozituar aktet përkatëse, por ka pranuar se ka ndjekur ankimimin gjyqësor kundrejt aktit administrativ të Komisionit Qendror të Ankimimit pranë ISSH, dhe se aktualisht vijon me procesin gjyqësor.

Në nenin 86 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, lidhur me të drejtën e ankimimit, parashikohet se:

“ 1. Ankimi kundër vendimeve të përfitimeve bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore; Ankimi në këto raste, depozitohet pranë sporteleve të shërbimit, në përputhje me legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel;

2. Ankimi kundër vendimeve të Komisionit të Ankimit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

3. Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në Gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar.....”.

Në Kapitullin III, të Rregullores nr. 1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, përcaktohen rregullat dhe procedurat për verifikimin e dokumenteve për pension, në të cilën përcaktohet se:

“1. Verifikimi bëhet nga inspektorët verifikues pranë arkivës së DRSSH-së, ASHV-të ose në subjektet që janë duke kryer aktivitetet ekonomiko-financiar. 2. Objekt verifikimi janë dokumentet që vërtetojnë periudhën e sigurimit dhe pagën..... 6. Procedura e verifikimit është si vijon: - Regjistri themeltar është dokumenti i parë që verifikohet. Nëse regjistri është i parregullt, pa datë fillimi ose pa datë mbylljeje të punës ose kur regjistri themeltar nuk ekziston, verifikimi vazhdon me librin e pagave. Në qoftë se libri i pagave ka parregullsi ose

kur libri i pagave nuk ekziston, atëherë verifikimi vazhdon me: Borderotë, listëpagesat. Në mungesë të tyre, verifikimi vazhdon me”.

Referuar në sa më sipër, vlerësohet se, DRSSH Fier, Komisioni Rajonal i Ankimit të DRSSH Fier dhe Komisioni Qëndror i Ankimit pranë ISSH-së, bazuar në legjislacionin e sipërcituar, kanë detyrimin ligjor për të verifikuar dokumentacionin e disponueshëm sipas përcaktimeve të Rregullores nr. 1, datë 21.10.2008.

Sikurse vihet re nga parashikimet e pikës 1 të Kapitullit të III të Rregullores “*Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve*”, janë inspektorët verifikues ato të cilët bëjnë shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit për llogaritjen dhe përfitimin e pensionit nga ana e kërkuesve.

Për sa më sipër, rezulton se pretendimi i ankuesit për mosnjohjen e kontributeve të paguara për 15 vitet e “blera” prej tij, bazuar në marrëveshjen vullnetare me DRSSH Fier, me nr. 1610, datë 19.07.2011, dhe llogaritjen e pasaktë të masës së pensionit të pleqërisë nga ana e subjekteve ndaj të cilëve është ankuar, pas shterimit të ankimit administrativ, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Rimarrja në shqyrtim e vendimeve të këtyre organeve (Komisioneve Rajonale të Ankimit, pranë DRSSH apo Komisioneve Qendrore të Ankimit, pranë ISSH) nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri vlerëson se ky është një pretendim që do të trajtohet nga organet gjyqësore dhe jo nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në ankesën e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është pretenduar se trajtimi i tij i pabarabartë apo i pafavorshëm nga DRSSH Fier, ka ardhur për shkak të moshës së tij.

Subjekti ankues, në rastin në fjalë ka dokumentuar se është përfitues i pensionit të pleqërisë, pra gëzon moshën e pensionistit, mbi 65 vjeç.

Së pari, dokumentimi i shkakut për të cilin pretendohet diskriminimi është thelbësor në çështjen e provimit të tij, për të cilin ankuesi pretendon se ka ardhur si pasojë e posedimit të tij.

Së dyti, pasi ankuesi të ketë provuar se mbart shkakun e pretenduar, duhet që ai të sjellë indicie, fakte apo prova që të dokumentojë, se pikërisht bazuar në këtë shkak, moshën e tij, ai është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme nga DRSSH Fier.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjektet ankues janë trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me shtetas/individë të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri vlerëson, se *apriori* shkak i pretenduar nga ankuesi, nuk mund të ketë shërbyer si shkak që mund të lidhet me trajtimin e tij të padrejtë apo të pafavorshëm, përsa i takon përlllogaritjes së masës së pensionit të pleqërisë nga ana e DRSSH

Fier, pasi është pikërisht gëzimi i këtij shkak (i moshës mbi 65 vjeç) mbi të cilin ai përfiton pensionin e pleqërisë. Pra, e gjithë kategoria e pensionistëve, që përfitojnë pension pleqërie duhet detyrimisht ta gëzojnë këtë shkak/cilësi, të jenë të moshës mbi 65 vjeç për të përfituar atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes lidhur me këtë shkak.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet përbën abuzim me të drejtën e ankimit para Komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 217 Regj., datë 18.11.2021, të subjektit ankues M. K, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: Mosha
Lloji i vendimit: Mospranim